

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6815
E enjte, 2 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

Kurti: Asociacioni njëetnik nuk është i mundshëm

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VLERA E KOEFICIENTIT TË PAGAVE PËR VITIN 2023 DO TË JETË 105 EURO

FAQE 4-5

SHPËRTHEJNË PAKËNAQËSITË PËR KOEFICIENTIN E RI TË PAGAVE



PAGA ME LIGJIN E RI PËR PUNËTORËT SHËNDETËSORË

(Pa përvojën e punës dhe shtesa të tjera)

Mjeku Specialist	PAGA BAZE AKTUALE NË € (BRUTTO)	1260	+601	91%
	PAGA BAZE NË € ME LIGJIN E RI (BRUTTO)*			RRITJA NË PËRQINDJE
Mjeku i përgjithshëm	PAGA BAZE AKTUALE NË € (BRUTTO)	565	+777	37%
	PAGA BAZE NË € ME LIGJIN E RI (BRUTTO)*			RRITJA NË PËRQINDJE
Kryeinfiermi në OKUK	PAGA BAZE AKTUALE NË € (BRUTTO)	471	+672	43%
	PAGA BAZE NË € ME LIGJIN E RI (BRUTTO)*			RRITJA NË PËRQINDJE
Kryeinfiermi në Spitale rajonale	PAGA BAZE AKTUALE NË € (BRUTTO)	471	+651	38%
	PAGA BAZE NË € ME LIGJIN E RI (BRUTTO)*			RRITJA NË PËRQINDJE

PAGA ME LIGJIN E RI PËR PUNËTORËT E ARSIMIT

(Pa përvojën e punës dhe shtesa të tjera)

Mësimdhënësi/ja në Shkollë Fillore dhe të Mesme të Ulët	PAGA BAZE AKTUALE NË € (BRUTTO)	421	588	+167	40%
	PAGA BAZE NË € ME LIGJIN E RI (BRUTTO)*				RRITJA NË PËRQINDJE
Mësimdhënësi/ja në Shkollë të Mesme të Lartë	PAGA BAZE AKTUALE NË € (BRUTTO)	459	609	+150	33%
	PAGA BAZE NË € ME LIGJIN E RI (BRUTTO)*				RRITJA NË PËRQINDJE
Mësimdhënësi/ja në Shkollë Speciale (Qendra Burimore)	PAGA BAZE AKTUALE NË € (BRUTTO)	434	609	+175	40%
	PAGA BAZE NË € ME LIGJIN E RI (BRUTTO)*				RRITJA NË PËRQINDJE
Edukatori/ja	PAGA BAZE AKTUALE NË € (BRUTTO)	393	546	+153	39%
	PAGA BAZE NË € ME LIGJIN E RI (BRUTTO)*				RRITJA NË PËRQINDJE

Vlera e koeficientit të pagave për vitin 2023 do të jetë 105 euro ka thënë të mërkurën, në mbledhjen e kabinetit qeveritar, kryeministri Albin Kurti. Ligji i ri i pagave në Kosovë pritet të hyjë

në fuqi gjatë këtij muaji. Sipas qeverisë, vlera e koeficientit do të ndryshojë në vitin 2024. Por për këtë koeficient kanë shprehur pakënaqësi opozita dhe shoqëria civile

AKTUALE



SHBA-ja DO TË JAPË EDHE
2 MILIARDË DOLLARË NDIHMË
USHTARAKE PËR UKRAINËN F. 2

SHOQATA BAMIRËSE "BEREQETI"
MERR PËRSIPËR RENOVIMIN E
PESË SHTËPIVE NË MITROVICË F. 7

NGA GRANTI I PËRFORMANCËS
KOMUNALE TË VITEVE TË
KALUARA, DRENASIT I SHTOHEN
MBI 400 MIJË EURO F. 6

EKONOMI



SEKTORI PRIVAT, "I DISKRIMINUAR"
NGA NDIHMA E SHTETIT F. 8

ZKA-JA: MBI 800 MIJË EURO VLERA
E DËMIT NGA MENAXHIMI I PRONAVE
SHOQËRORE NGA AKP-ja F. 8

SPORT



KATEGORIZIMI I SPORTISTËVE,
DISTRIA E NORA ME PIKË MAKSIMALE
F. 10



KRASNIQI DHE
HARADINAJ
TAKOJNË
ESCOBARIN:
MARRËVESHJA
ME SERBINË DUHET
TA PËRFSHIJË
NJOHJEN



KER-LINDSEY: VËSHTIRË
TË ARRIHET MARRËVESHJE NË
MES TË KOSOVËS DHE SERBISË
PA NJOHJE RECIPROKE

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Turqia shpreh qëndrim pozitiv për anëtarësimin e Finlandës në NATO

ANKARA, 1 SHKURT - Turqia e shikon me pozitivitet aplikimin e Finlandës për anëtarësim në NATO, por nuk mbështet atë të Suedisë, tha presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan. "Qëndrimi ynë ndaj Finlandës është pozitiv, por nuk është pozitiv ndaj Suedisë", tha Erdogan më 1 shkurt gjatë një fjalimi në Parlamentin turk. Vitin e kaluar Suedia dhe Finlanda aplikuan për anëtarësim në NATO pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës. Megjithatë, këto dy shtete u përballën me kundërshti nga Turqia dhe që atëherë kanë tentuar t'i përmbushin kushtet e vëna nga Ankaraja.

Ankaraja dëshiron që Helsinki, dhe Stokholmi në veçanti, të ndërmarrin një qëndrim më të ashpër kundër Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit, që konsiderohet grup terrorist nga Turqia dhe Bashkimi Evropian,

dhe ndaj një grupi tjetër që pala turke fajëson për puçin e dështuar ushtarak të vitit 2016. Tri shtetet arritën një marrëveshje në qershorin e kaluar për rrugën përpara, por Ankaraja muajin e kaluar pezulloi bisedimet pas rritjes së tensioneve që u shkaktuan nga një protestë në Stokholm, ku u dogj një kopje e Kuranit, librit të shenjtë të myslimanëve. "Në këtë pikë, Suedia nuk duhet as të tentojë. Ne nuk do të themi 'po' për aplikimin e tyre për në NATO për aq kohë sa ata lejojnë djegien e Kuranit", tha Erdogan. Gjatë fundjavës së kaluar lideri turk sinjalizoi se Ankaraja mund të pajtohet që Finlanda të anëtarësohet në NATO para Suedisë. Por, ministri i Jashtëm finlandez, Pekka Haavisto, tha të hënën se shteti i tij vazhdon ta mbajë qëndrimin që dy shtetet të anëtarësohen së bashku.

Nga 30 shtete anëtare të NATO-



s, vetëm Turqia dhe Hungaria ende nuk kanë ratifikuar pranimin e dy shteteve nordike në aleancën ushtarake perëndimore.

I pyetur nëse Turqia ka plane që të ketë procese të ndara për

Finlandën dhe Suedinë, ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavugoslu, tha se NATO dhe dy shtetet nordike janë ato që vendosin nëse do të ketë ratifikime të ndara. "Nëse NATO dhe dy shtetet vendosin për

procese të ndara të anëtarësimit, Turqia sigurisht se do ta rishqyrtojë veçmas anëtarësimin e Finlandës dhe në mënyrë më favorizuese", tha Cavugoslu gjatë vizitës në Estoni.

ShBA-ja do të japë edhe 2 miliardë dollarë ndihmë ushtarake për Ukrainën



WASHINGTON, 1 SHKURT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë duke përgatitur më shumë se 2 miliardë dollarë ndihmë ushtarake për Ukrainën e cila për herë të parë pritet të përfshijë raketa me rreze më të gjatë veprimi, si dhe municione dhe armë të tjera, i thanë "Reuters"-it më 31 janar dy zyrtarë amerikanë të informuar për këtë çështje. Ndihma pritet të shpallet brenda kësaj jave dhe do të përfshijë pajisje mbështetëse për sistemet e mbrojtjes ajrore Patriot dhe armë antitank Javelin, thanë zyrtarët.

Në total, Shtetet e Bashkuara kanë ndarë mbi 27 miliardë

dollarë si ndihmë për Ukrainën, prej kur Moska ka nisur luftën në shkurt të vitit të kaluar.

Aleatët perëndimorë kanë ofruar armë në vlerë të miliarda dollarëve për Ukrainën.

Së fundmi, Ukrainës i janë premtuar edhe tanke gjermane dhe amerikane.

Rusia që ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt 2022 ka më shumë tanke sesa Ukraina, por modelet që Moska ka janë shumë inferiore krahasuar me tanket perëndimore.

Si Rusia, ashtu edhe Ukraina, presin që të nisin ofensiva gjatë javëve në vijim, dhe tanket pritet të luajnë rol vital në këto beteja, kanë vlerësuar ekspertët.

Petr Pavel: Ukraina duhet t'i bashkohet NATO-s pas përfundimit të luftës

PRAGË, 1 SHKURT - Presidenti i sapozgjedhur çek Petr Pavel i ka thënë BBC-së se Ukraina duhet të lejohet që t'i bashkohet NATO-s "sapo të përfundojë lufta".

Pavel, një gjeneral në pension, tha se Ukraina do të ishte "moralisht dhe praktikisht e gatshme" për t'u bashkuar me aleancën perëndimore pas përfundimit të konfliktit. "Ushtria ukrainase do të jetë ndoshta ushtria më me përvojë në Evropë. Ukraina meriton të jetë pjesë e një komuniteti të vendeve demokratike", tha ai.

Në intervistën e tij të parë të transmetuar në medie ndërkombëtare që nga zgjedhja e tij, Pavel i dha mbështetje të fortë ndihmës ushtarake perëndimore për Kievin.

Duke folur nga Praga, ai tha se dërgimi i avionëve luftarakë perëndimorë si F-16 nuk është temë "tabu" për të, por tha se nuk ishte i sigurt se ata mund të dorëzoheshin në një afat kohor që mund të ishte i dobishëm për Kievin.

Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, e ka përjashtuar mundësinë e dërgimit të F-16 në Ukrainë,

megjithëse presidenti francez Emmanuel Macron ka thënë se asgjë nuk përjashtohet. "Jam krenar që vendi im është një nga të parët që i ka ofruar Ukrainës ndihmë të konsiderueshme ushtarake", tha ai për BBC.

Republika Çeke ishte vendi i parë perëndimor që dërgoi tanke dhe automjete luftarake të këmbësorisë - T72 dhe BMP1 të dizajnuara nga sovjetikët - në Kiev, pjesë e një serie dërgesash të armëve të rënda që thuhet se filluan që në mars të vitit 2022.

Pothuajse një vit më vonë, pas shumë kërkesash nga Ukraina,



vendet si Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermania, janë pajtuar për të dërguar tanke moderne, të prodhimit perëndimor si Leopard 2, Challenger dhe M1 Abrams. "Ndoshta shumë pak njerëz mund të imagjinonin se vendet perëndimore do të ishin të gatshme t'i siguronin Ukrainës tanke moderne luftarake ose sisteme artilerie me rreze të gjatë", tha ai.

Ukraina ka kërkuar 300 tanke të tilla dhe thotë se Perëndimi deri më tani ka premtuar se do t'ia dërgojë të paktën 120.

Krasniqi dhe Haradinaj takojnë Escobarin: Marrëveshja me Serbinë duhet ta përfshijë njohjen

Uashington, 1 shkurt - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, gjatë vizitës së tij në ShBA, është takuar me zëvendësndihmësin e sekretarit të Shtetit, Gabriel Escobar, me të cilin tha se ka diskutuar për zhvillimet aktuale

politike në Kosovë dhe rajon. Në diskutimin me Escobarin, lideri i PDK-së ka pohuar se marrëveshja me Serbinë duhet ta përfshijë njohjen. "Gjatë vizitës zyrtare në ShBA takova zëvendësndihmësin e sekretarit të Shtetit, që është edhe i dërguari i



posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, z. Gabriel Escobar, me të cilin diskutuam për zhvillimet aktuale politike në Kosovë dhe rajon. Z. Escobar i shpreha edhe një herë qëndrimin e vazhdueshëm të PDK-së në lidhje me procesin e dialogut me Serbinë dhe nevojën e arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërish dhe ndërkombëtarisht të obligueshme, që përfshinë njohjen reciproke", ka bërë me dije Krasniqi.

Ai ka theksuar se për Kosovën, rreshtimi dhe koordinimi me ShBA-në është i paalternativë në

rugën e integritit dhe forcimit të shtetit tonë. "Fuqizimi i raporteve bilaterale dhe strategjike ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së është i padiskutueshëm dhe i pandryshueshëm", ka deklaruar Krasniqi.

E kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se është ndier i nderuar që ta takojë Gabriel Escobarin në Departament të Shtetit. "Në një takim të hapur dhe të sinqertë diskutuam për zhvillimet politike në Kosovë, me theks të veçantë për nevojën për arritjen e marrëveshjes finale, ligjërish të obligueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. Falënderova

z. Escobar për angazhimin e tij dhe të administratës amerikane tash e shumë dekada dhe e inkurajova për thellim të marrëdhënieve dhe që mbështetja ndaj Kosovës të shtohet", ka deklaruar Haradinaj. Ai ka thënë se arritjet e Kosovës nga vitet '90, lufta çlirimtare dhe shtetndërtimi kanë ndodhur në partneritet të përbashkët. "Edhe marrëveshja finale duhet të jetë fitore e përbashkët. Do të punojmë ngushtë me ShBA-në që partneriteti për paqe dhe anëtarësimi i Kosovës në NATO të arrihet me urgjencë pasi që është jetike për paqe të qëndrueshme në rajon", ka theksuar Haradinaj.

Kurti: Asociacioni njëetnik nuk është i mundshëm

PRISHTINË, 1 SHKURT - "Asociacion njëetnik në Kosovën me Kushtetutë shumetnike nuk është i mundshëm", tha kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pas vizitës që i bëri një biznesi të këpucëve në Ferizaj. Ai tha se nëse Serbia dëshiron që në Kosovë të ketë zgjedhje njëetnike, "le ta provojë njëherë në shtëpinë e saj". "Pakicat kombëtare në Serbi janë gati 20 për qind, pakicat kombëtare në Kosovë janë rreth 7 për qind, pra Asociacion i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, e Presheva, Medvegja e Bujanovci ta kenë vetëm Këshillin Nacional atje, është e padrejtë, e dëmshme dhe e papranueshme", tha Kurti të mërkurën.

Ai tha se është i hapur për diskutime mbi bazën e propozimit evropian por, siç tha, "mua më duhet, mbi të gjitha, ta respektoj kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë".

Ambasada Amerikane në Prishtinë organizoi të martën një diskutim të mbyllur për Asociacionin. Pas takimit, ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, tha se vendi i

tij e ka bërë të qartë tashmë se "nuk mbështet asnjë marrëveshje që shkel Kushtetutën e Kosovës" ose që "kërcënon sovranitetin, pavarësinë dhe karakterin shumetnik" të saj. Hovenier tha se ShBA-ja pret që Kosova t'i përmbushë obligimet e saj. "Ne kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që ta ofrojë vizionin e saj për Asociacionin, që beson se mbron të ardhmen e Kosovës si shtet sovran, i pavarur, shumetnik, demokratik, dhe siguron të drejtat e pakicave në përputhje me marrëveshjet e Brukselit dhe Kushtetutën e Kosovës", tha Hovenieri.

Marrëveshja për formimin e këtij asociacioni është arritur në vitin 2013 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, por ajo nuk është zbatuar kurrë.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar më 23 dhjetor të vitit 2015 se parimet e përgjithshme të Asociacionit, të dakorduara po atë vit në mes të Kosovës dhe Serbisë, nuk janë tërësisht në përputhje me



frymën e Kushtetutës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese ka thënë se ky asociacion mund të formohet nëse parimet që nuk janë në harmonizim me Kushtetutën,

harmonizohen. Serbia, në anë tjetër, këmbëngul që Asociacioni të formohet në bazë të marrëveshjeve të arritura. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi

Evropian kanë kërkuar vazhdimisht nga palët që t'i respektojnë të gjitha marrëveshjet e arritura, përfshirë atë për Asociacionin.



VLERA E KOEFICIENTIT TË PAGAVE PËR VITIN 2023 DO TË JETË 105 EURO

Shpërthejnë pakënaqësitë për koeficientin e ri të pagave

Vlera e koeficientit të pagave për vitin 2023 do të jetë 105 euro ka thënë të mërkurën, në mbledhjen e kabinetit qeveritar, kryeministri Albin Kurti. Ligji i ri i pagave në Kosovë pritet të hyjë në fuqi gjatë këtij muaji. Sipas qeverisë, vlera e koeficientit do të ndryshojë në vitin 2024. Por për këtë koeficient kanë shprehur pakënaqësi opozita dhe shoqëria civile

Kosovës janë mbështetur më së shumti ata që kanë qenë në fund të tabelës, punëtorët e teknikët kudo nëpër administratën tonë qendrore e lokale, do ta kenë trajtimin e tyre dinjitoz dhe të drejtë. “E reja e këtij sistemi, përveç vlerave që ka sjellë në klasifikimin e

kategorive të zyrtarët publikë, është se për çdo vit do të vlerësohen mundësitë buxhetore dhe do të bëhet ndryshimi i koeficienteve sipas atyre mundësive. Pra, pas kësaj, nuk do të ketë më stagnim të pagave të zyrtarëve pafundësisht. Ato do të lëvizin

sipas rritjes apo më mirë të themi sipas punës dhe rezultateve, që kemi të gjithë në bashkë në rritjen ekonomike të vendit. Për herë të parë fondi i pagave në Republikën e Kosovës po rritet 100 milionë euro”, ka deklaruar kryeministri Kurti, duke shtuar se për çdo vit, për shkak të punësimit apo lëvizjeve të tjera, fondi i pagave ka pasur rritje apo lëvizje jo më shumë se 20 deri në 25 milionë.

Sipas Ligjit të Pagave në sektorin publik, koeficientin më të lartë e ka pozita e presidentit, 18, që i bie se paga e presidentit është 1 890 euro. Pas presidentit renditet kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me koeficient 17.5. Koeficienti i kryetarit të Kuvendit dhe kryeministrit është 17, ndërsa e deputetit dhe ministrit është 16.4.

Koeficientin 15 e ka komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndërsa 14.5 e kanë drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe ai i Doganës.

Prokurorët dhe gjyqtarët, varësisht nga niveli, i kanë koeficientet nga 12 deri në 14.5. Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës e ka koeficientin 14.

Me koeficient të njëjtë është


EPOKA ERE Mal QORRAJ

Prishtinë, 1 shkurt - Vlera e koeficientit të pagave për vitin 2023 do të jetë 105 euro tha kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë mbledhjes së qeverisë të mërkurën. Ai tha se kjo vlerë e koeficientit do të ndryshojë në vitin 2024, dhe nga janari i vitit tjetër do të jetë 110 euro. “Prej dhjetorit, kur Kuvendi miratoi Ligjin e Pagave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Financave, Punës dhe Transfereve kanë bërë përllogaritjet e nevojshme, klasifikimin e plotë të pozitave sipas Ligjit të ri të Pagave të 82 mijë zyrtarëve publikë. Pas këtij procesi voluminoz dhe shumë kompleks, është mbërritur te vlera e koeficientit për vitin 2023 dhe ai është 105 euro. Ndërsa në

janar të vitit 2024, sipas përllogaritjeve të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ai do të jetë 110”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se me këtë ndryshim-plotësim të Ligjit të Buxhetit i hapet rrugë sistemit të ri të pagave në Republikën e Kosovës prej këtij muaji. “Me këtë sistem të ri dhe këto vlera të reja të kompensimeve ne kemi synuar dhe mbërritur disa objektiva bazë: Barazi dhe ndershmëri për pagat në mes të kategorive, ngushtim të hendekut midis zyrtarëve të lartë dhe të tjerëve, si dhe mbështetje solide për katër kategoritë jetike për funksionimin e shoqërisë, atë të mjekëve, arsimtarëve, policëve dhe ushtarakëve”, është shprehur ai.

Po ashtu, Kurti ka thënë se në shërbimin civil të Republikës së





edhe drejtori i ShSKUK-së, ndërsa mjeku specialist e ka koeficientin 12, mjeku në specializim 8, mjeku i përgjithshëm, stomatologu dhe farmacisti e kanë koeficientin 7.4.

Ndërsa infermierët, varësisht nga niveli, e kanë koeficientin prej 5.1 deri në 5.6. Mësimdhënësi në shkollë të mesme të lartë e ka koeficientin 5.8, që i bie se paga është 609 euro. Ndërsa mësimdhënësi në shkollë fillore dhe të mesme të ulët e ka koeficientin 5.6, që i bie 588 euro.

Polici e ka koeficientin 5, ndërsa polici i lartë 5.9. Nëse një zrytar publik para hyrjes në fuqi të këtij Ligji kishte pagë më të madhe se paga e re, i njëjti do ta përfitojë pagën e re sipas dispozitave të Ligjit të ri dhe shtesën transitorë të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë, thuhet në nenin 41. Aty thuhet se gjatë vitit të parë shtesa transitorë do të jetë 100 për qind, kurse gjatë vitit të dytë ajo do të zbritet në 50 për qind. "Përrjashtim nga kjo dispozitë bëjnë anëtarët e shërbimit të

jashtëm", thuhet në këtë nen.

Opozita lëshon seancën në shenjë pakënaqësie me vlerën e koeficientit

Tri partitë opozitare në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë lëshuar sallën e Kuvendit të mërkurën në shenjë pakënaqësie me vlerën e koeficientit të përcaktuar nga Qeveria e Kosovës.

Pagat e punëtorëve në Kosovë llogariten duke e shumëzuar koeficientin e pagës së një pozite me vlerën monetare të koeficientit. Raporti i koeficienteve është nga një deri në 18.

Kreu i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, tha se partia e tij është e zhgënjyer me vlerën e koeficientit dhe e quajti atë "koeficient të mjerimit" që, sipas tij, "e thëllon varfërinë". "Ky koeficient i demotivon të rinjtë e të rejtat që duan të jenë pjesë e administratës", tha ai. Ndërkaq kryetari i LDK-së,


Lumir Abdixhiku, ka theksuar se ky është koeficienti i zbrzjes së Kosovës. "Në krizën më të madhe ekonomike e sociale ndër vite, qeveria sërish tregoi pandjeshmëri. Pandjeshmëri ndaj përballjes qytetare, ndaj rritjes së kostos së jetesës, ndaj njerëzve të këtij vendi. Koeficienti në vlerë prej vetëm 105 është goditje e radhës ndaj mjekëve, mësuesve, policëve, ushtarëve e gjithë shërbyesve publikë. Është braktisje e njerëzve të vendit, që shkakton braktisjen e tyre të vendit", ka thënë ai. Abdixhiku ka treguar se LDK-ja ka propozuar koeficient në vlerë prej 125 eurosh. "Gjithçka më

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar rreth koeficientit për paga. Ai ka theksuar se sot qeveria Kurti i vuri vulë mashtrimit. Sipas Haradinajt, fshehja e deritashme e koeficientit kishte për qëllim t'i zë në befasi të pakënaqurit me këtë vendim. "E ata janë shumë! Krejt ky veprim i qeverisë, në mënyrë që ta sabotojë mundësinë për sfidimin dhe shfrytëzimin e proceseve dhe mekanizmave ligjorë kundër këtij ligji i cili nëpunësit dhe profesionistët shtetërorë i trajton si 'armiçësorë', i anatemon. Kishte për qëllim t'i fusë në debate dhe përplasje edhe përfaqësuesit e

mashtres!", ka deklaruar Haradinaj Pasi deputetët e opozitës e kanë lëshuar sallën, seanca është ndërprerë në mungesë të kuorumit.

KDI-ja: Qeveria përmes koeficientit ul pagat dhe cenon pavarësinë e gjyqësorit

KDI-ja ka vlerësuar se kjo vlerë e koeficientit prej 105 eurosh nuk përkon me pritshmëritë dhe kërkesat e punëtorëve të sektorit publik. "Për më tepër e metë kryesore e këtij ligji mbetet çështja e ndërhyrjes në sistemin e drejtësisë. Kjo vlerë e koeficientit e zhvlerëson pozitën e gjyqtarit dhe prokurorit duke ua ulur pagat për rreth 25 %. Kështu një gjyqtar i Gjykatës Themelore do të paguhet 1 200 euro, ndërkohë që paga e tij/saj bazë ishte 1 600 euro në muaj. Ulja e pagave aktuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që nga qeveria po arsyetohet si arritje e 'barazisë' së pagave në sektorin publik, është kundër kushtetuese dhe në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti nr. KO 219/19. Ulja e pagave është në kundërshtim edhe me Ligjin për Gjykatat, i cili qartazi përcakton se pagat e gjyqtarëve nuk mund të zvogëlohen gjatë mandatit për të cilin ata janë emëruar, përveç në rastet kur vendosen sanksione disiplinore nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës", ka theksuar KDI-ja. Sipas KDI-së, shfuqizimit të këtyre dispozitave patjetër duhet t'i paraprijë një arsyetim nga ekzekutivi, i cili duhet të jetë nën frymën e "parashikushmerisë" dhe "sigurisë juridike" që duhet të ofrojë ky ligj. "Çështja e uljes së pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve është kritikuar edhe nga ana e ekspertëve të Komisionit Evropian dhe Zyrës së BE-së në Kosovë. Ata kanë konsideruar se ulja e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve me ligjin e ri, sidomos në një shumë kaq të konsiderueshme, është shumë shqetësuese dhe rrezikon ta cenojë parimin e pavarësisë së gjyqësorit. Edhe praktikat gjyqësore të shteteve të tjera evropiane si dhe Komisioni i Venecias kanë theksuar faktin se paga e gjyqtarit individual mund të ulet vetëm si pasojë e një krize të evidentuar ekonomike që do të përbënte rrethanë të jashtëzakonshme për shtetin, e në kontekstin aktual nuk kemi ndonjë krizë ose gjendje të jashtëzakonshme ekonomike të shpallur nga qeveria. Përkundrazi, Kosova këtë vit ka miratuar buxhetin më të madh ndonjëherë, në vlerën prej rreth 3,2 miliardë eurosh. Andaj një ulje e tillë e pagave për sistemin e drejtësisë cenon parimin e ndarjes të pushteteve dhe është ndërhyrje direkte në pavarësinë e pushtetit gjyqësor", ka theksuar KDI-ja.



pak se aq është ulje e pagave për disa e mosrritje për të tjerët. Është injorim i inflacionit e kushteve të rënduara të jetesës. Këtë propozim do ta dërgojmë menjëherë edhe si amendament në Kuvend. Një qeveri të shpërputhur nga realiteti, vendi ynë nuk e meriton. Kosova meriton më mirë. Kosova mundet më shumë", ka deklaruar Abdixhiku.

ndryshëm sektorialë, duke bërë rritje të kamufluara për disa sektorë, nivele dhe pozita, përderisa shumicës ia konfirmon ato paga që i kishte tashmë. Ligji sipas këtij koeficienti ka krijuar terren për kundërshtimeve opozitare të një vendimmarrjeje qeveritare arbitrare dhe përrjashtuese. Kjo qasje është fyese! Ky koeficient është alarmues dhe



Dardan Abazi nga shoqëria civile emërohet drejtor i Arsimit në Vushtrri

VUSHTRRI, 1 SHKURT - Ferit Idrizi, kryetar i komunës së Vushtrrisë, ka emëruar Dardan Abazin nga shoqëria civile, drejtor i Arsimit. "Sot

kam emëruar z. Dardan Abazin drejtor të Arsimit, i cili vjen nga shoqëria civile. Ka një përvojë të gjatë në politikën publike, mbi një

dekadë në analizën e politikave publike, hartues i projekteve vendore e ndërkombëtare në sektorin e shoqërisë civile, si dhe me

një përvojë të gjatë në reformën e administratës publike. Na priftë e mbara, Dardan!", ka shkruar Idrizi në "Facebook".



Kurti përkujtoi dëshmoren e lirisë Elfete Humolli

PODUJEVË, 1 SHKURT - Në 33-vjetorin e rënies së dëshmores së lirisë Elfete Humolli, kryeministri Albin Kurti së bashku me nënkryetaren e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci, bënë homazhe te kompleksi memorial në Lupç të Poshtëm. Kurti pastaj vizitoi familjen Humolli, ku u prit nga nëna Sevdije, nëna e dy

dëshmorëve, Elfetes dhe Mentorit, i cili ra dëshmor më 21 mars 1999 gjatë luftimeve në Koshare. "Risollën në kujtesë 1 shkurtin e vitit 1990, kur 33 vjet më parë, duke demonstruar për lirinë e Kosovës në fshatin Lupç i Poshtëm, Elfete Humolli, dy javë para ditëlindjes së 17-të, ra dëshmore e lirisë, e vvarë nga

policia serbe. Atë ditë ajo bashkë me mijëra demonstrues shqiptarë nga fshatrat e kësaj ane të Llapit po thërrisnin për demokraci, e përballë pushtetit të Serbisë po demonstironin për të drejta politike, për liri dhe kundër shtypjes nga regjimi serb. Në demonstratën e 1 shkurtit 1990 policia serbe shtiu me breshëri

në drejtim të demonstruesve duke goditur katër prej tyre: Elfete Humolli vdiq nga plagët në vend, kurse Eset Kaçiu, Ismet Krasniqi dhe Avni Retkoceri mbetën të plagosur", ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se familjarët rrëfyan se atë ditë Elfetja ishte agjërueshëm dhe para frymës së fundit, kishte pyetur për vëllanë

e saj 13-vjeçar Mentorin, nëse kishte shpëtuar. "Në rrugën e gjatë të popullit të Kosovës për t'u çliruar nga Serbia pushtuese, të ardhur nga dy rrugë të ndryshme, liria si destinacion i bashkoi motër dhe vëlla: Elfeten demonstruese për çlirim dhe Mentorin luftëtar të UÇK-së që ranë dëshmorë për lirinë e Kosovës", ka deklaruar Kurti.



Nga granti i performancës komunale të viteve të kaluara, Drenasit i shtohen mbi 400 mijë euro

Drenas, 1 shkurt - Në kohën kur ka mbetur edhe pak kohë para shpalljes së fituesve të grantit të performancës komunale për vitin 2022, buxheti i komunës së Drenasit është mbushur edhe me plot 400 953 euro, mjete këto të fituara më herët nga ky grant.

Pjesa tjetër e mjeteve që u shtuan në buxhetin e komunës së Drenasit do të shërbejë për realizimin e projekteve kapitale,



që do ta rritin mirëqenien sociale të kësaj komune. "Komuna e Drenasit mbetet e përkushtuar për arritjen e sukseseve të tjera në performancën komunale përmes së cilës shtohet buxheti komunal në vlerë prej miliona euro e që ndikon drejtpërdrejt te qytetarët me realizimin e projekteve të ndryshme të cilat përcaktohen sipas prioriteteve të tyre. Pas periudhës së

vështirë të pandemisë dhe periudhës së krizës globale, krizë kjo që preku e gjithë botën dhe jo vetëm vendin tonë, prej së cilës stagnuan punimet nga kompanitë të cilave u ishte rritur kostoja e materialeve për punët që do t'i realizonin, tashmë do të vazhdojmë pa ndalur në realizimin e projekteve që janë në të mirë të të gjithë qytetarëve tanë", ka njoftuar komuna e Drenasit.

Vazhdon puna në plotësimin- ndryshimin e statutit të ri të komunës së Malishevës

Malishevë, 1 shkurt - Komisioni për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të komunës së Malishevës e ka vazhduar edhe të mërkurën punën e tij dhe

brenda pak kohe pritet që draft i ri i statutit të komunës të dalë në diskutim publik, më pas të miratohet në kuvend dhe Malisheva ta ketë statutin

e ri. Ky komision është i formuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës dhe janë duke u angazhuar maksimalisht që të hartohet drafti i ri statutit

të komunës, si akti më lartë juridik që miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe i cili rregullon organizimin e brendshëm të komunës.



Ker-Lindsey: Vështirë të arrihet marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë pa njohje reciproke

Prishtinë, 1 shkurt - Njohja reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë në fokus të marrëveshjes mes dy vendeve, ka thënë James Ker-Lindsay, profesor në Shkollën Ekonomike të Londrës, në një intervistë për Shërbimin e Ballkanit të "Radios Evropa e Lirë". Ai beson se plani aktual i Bashkimit Evropian për normalizim të marrëdhënieve nuk është hap drejt arritjes së një marrëveshjeje finale dhe të qëndrueshme.

Propozimi i Bashkimit Evropian, që në publik njihet si plani franko-gjerman, u është dorëzuar autoriteteve në Kosovë dhe Serbi në fund të verës së kaluar. Ky propozim, në të cilin ka pasur qasje "Radio Evropa e Lirë", parasheh të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim të integritetit territorial, paprekshmëri të kufijve, njohje të simboleve

shtetërore dhe një aranzhim të veçantë për komunitetin serb në Kosovë. "Është padyshim e vështirë të thuhet, dhe mendoj se pika tjetër që duhet ngritur është se, edhe nëse plani çohet tutje, nuk është saktësisht marrëveshje përfundimtare. Dua të them se prapëseprapë e lë të hapur pozicionimin e Serbisë ndaj Kosovës. Nuk e zgjidh atë. Disa mund të thonë se është një hap përpara. Unë e kam parasysh atë argument. Në fakt unë jam mjaft kritik ndaj këtij plani, sepse nuk mendoj se është mjaft ambicioz. Mendoj se e kuptoj pse edhe Serbia edhe Kosova do të ndihen shumë të pakënaqura për këtë. Disa do të thoshin, mirë, shikoni, kjo është në fakt një bazë vërtet e mirë për një hap tjetër. Nëse të dyja palët thonë mirë, kjo nuk është në të vërtetë ajo që ne do të dëshironim, por mendojmë se është diçka që i çon gjërat një

hap përpara. Shikoni, Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara mund ta konsiderojnë këtë si një rezultat pozitiv, veçanërisht, sipas meje, pasi ata e ndiejnë se palët nuk e dëshirojnë një gjë të tillë", ka thënë ai, duke shtuar se në fund të fundit nuk mendon se kjo është një marrëveshje veçanërisht efektive. "Unë e shoh si diçka që është krijuar më shumë nga zhgënjimi se çdo gjë tjetër, pasi evropianët e shohin këtë si një çështje të rëndësishme se janë të brengosur ndaj ndikimit të Rusisë në Ballkan dhe kanë thënë të provojmë e të shohim se çfarë mund të bëjmë. Por, me të vërtetë e kuptoj pse të dyja palët do të jenë të pakënaqura me të. Pyetja është, natyrisht, nga pala serbe, nëse presidenti [Vuçiq] mendon se mund t'ia mbushë mendjen opozitës për këtë, sepse do të jetë efektivisht një hap mjaft domethënës nëse

do të bëhet, që kjo do ta lë Serbinë në një pozicion nominalist [...idetë e përgjithshme janë thjesht emra pa ndonjë realitet përkatës...]", ka theksuar Ker-Lindsay. Ai ka thënë se mund ta kuptojë pse Kosova është shumë e pakënaqur për këtë, sepse nuk po u jep atyre garancitë e njohjes që ata padyshim dëshirojnë t'i kenë. "Pra, një përgjigje mjaft e gjatë, por do të thosha se është shumë e vështirë të thuhet se sa afër janë palët për një marrëveshje përfundimtare, sepse ky nuk është në të vërtetë një negociim mes palëve. Kjo është një negociatë mes Serbisë dhe Bashkimit Evropian e Shteteve të Bashkuara dhe ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian e Shteteve të Bashkuara. Nuk është një marrëveshje në thelb mes Serbisë dhe Kosovës", ka deklaruar James Ker-Lindsay.

Ai ka pohuar se në këtë proces të dialogut ka pakënaqësi. "Epo, mendoj se është e rëndësishme të përmend se e them këtë si dikush që ka punuar në shumë procese paqeje gjatë viteve dhe kam mjaft përvojë praktike në këtë, si dhe fakti që kjo është fusha ime akademike e studimit - zgjidhja e konflikteve. Kështu që mendoj se është e rëndësishme të thuhet se disa do të thonë, 'mirë, nëse të dy janë të pakënaqur, atëherë kjo është një shenjë e mirë'. Jo, mendoj se është pak më e ndjeshme se kaq. Kemi procese paqeje ku shkenca del dhe thotë, shikoni, ne jemi të pakënaqur me X, Y dhe Z, por në përgjithësi ne mund të jetojmë me të. Kjo nuk është aso lloj marrëveshjeje. Unë mendoj se ajo që do të shohim këtu është pakënaqësi, e cila, në fakt, nuk e zgjidh problemin, përkundrazi, ngre problem", thotë Ker-Lindsay.



Shoqata Bamirëse "Bereqeti" merr përsipër renovimin e pesë shtëpive në Mitrovicë



MITROVICË, 1 SHKURT - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të mërkurën në takim drejtorin e Shoqatës Bamirëse "Bereqeti", Behxhet Ajvazi, sekretarin e kësaj shoqate, Xheladin Fazliu, si dhe koordinatoret e shoqatës në Mitrovicë, Cena Bala dhe Armend Haxhiu. Në këtë takim është biseduar lidhur për situatën në komunë pas vërshimeve dhe për dëmet e shkaktuara nga kjo fatkeqësi natyrore.

Kjo shoqatë, e cila funksionon në kuadër të kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, duke parë situatën e krijuar pas vërshimeve në Mitrovicë, ka

shprehur gatishmërinë që ta mbështesë komunën me renovimin e pesë shtëpive për familjet e prekura nga vërshimet.

Po ashtu, Shoqata Bamirëse "Bereqeti", së bashku me shoqatën "Swiss Bereket" me seli në Zvicër, do ta bëjnë shpërndarjen edhe të 30-35 pakove ushqimore dhe higjienike dhe nga një zarf në vlerë 40 euro për këto familje.

Kryetari Hamza ka falënderuar Shoqatën "Bereqeti" dhe stafin e saj për ndihmën dhe solidaritetin e treguar ndaj familjeve që kanë pësuar dëme të shumta në shtëpitë e tyre nga vërshimet.

Sektori privat “i diskriminuar” nga ndihma e shtetit

PRISHTINË, 1 SHKURT - “Nuk e ndiejmë që jemi shtetas të Republikës së Kosovës. Shteti po na diskriminon”, thotë Hysni Gashi, i punësuar në një kompani pastrimi në sektorin privat.

Gashi, sikurse të punësuarit e tjerë në këtë sektor, nuk ka marrë ndihmën prej 50 eurosh të ndarë nga Qeveria e Kosovës për muajin janar, me qëllim të, siç është thënë, përballimit më të lehtë të inflacionit.

Qeveria ka ndarë ndihma të ngjashme katër herë nga shtatori i vitit të kaluar, por vetëm për punonjësit e sektorit publik. “Kjo është e padrejtë. Inflacioni na ka prekur edhe ne. Tatimin në pagë e paguajmë njëjtë si unë që punoj në sektorin privat, si ata që marrin pagë nga buxheti i shtetit”, thotë Gashi për “Radion Evropa e Lirë”.

Kosova e ka mbyllur vitin 2022 me normë mesatare vjetore të inflacionit 11.6 për qind krahasuar me 3.1 për qind sa ka qenë në vitin 2021.

Rritja e çmimeve ka nisur nga viti 2021 si pasojë e çrregullimeve në tregje që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit, ndërsa ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022, sidomos pasi Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës në fund të shkurtit.

Gashi thotë se në kompaninë ku punon tash e 16 vjet paguhet rreth 300 euro në muaj dhe se nga kjo pagë varet gati e gjithë familja e tij katëranëtarëshe. “Nuk janë vetëm çmimet e rritura që nuk po i përballojmë, është edhe qiraja, uji, rryma. Po e kemi problem t’ia dalim. Kam pasur nevojë jo vetëm për 50 euro, por edhe për më shumë”, thotë ai.

Nga pakot mbështetëse të Qeverisë së Kosovës punëtorët e sektorit privat me pagë mujore nën 1 000 euro kanë marrë në maj të vitit të kaluar nga 100 euro.

Paga mesatare në Kosovë vitin e kaluar ka qenë rreth 480 euro.

Agjencia e Statistikave e Kosovës ka publikuar në muajin dhjetor një raport për kushtet e jetesës në vitin 2020, në të cilin është konstatuar se 52 për qind e ekonomive familjare kanë pasur vështirësi për kryerjen e pagesave të nevojshme, ndërsa 57 për qind e ekonomive familjare nuk kanë mundur të mbulojnë me mjete vetjake një shpenzim të papritur prej 100 eurosh.

Për shkak të rritjes së inflacionit, këto shifra tani mund të jenë edhe më të larta.

Azemi: Inflacioni ka prekur më shumë sektorin privat

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat në Kosovë, Jusuf Azemi, thotë se vendimi i qeverisë për t’i ndihmuar vetëm të punësuarit në sektorin publik është i padrejtë. Duke folur për “Radion Evropa e Lirë”, ai thotë se sindikata ka kërkuar vazhdimisht nga qeveria që të ndihmohen edhe të punësuarit në sektorin privat, por nuk ka marrë ndonjë përgjigje. “Inflacioni ka prekur më shumë të punësuarit në sektorin privat, pasi që pagat janë më të ulëta. Në sektorin privat punëtorët vazhdojnë të paguhet me pagë minimale. Janë në situatë të vështirë e të diskriminuar nga shteti”, thotë Azemi.

Vlera e pagës minimale në



Kosovë, që sillet nga 130 deri në 170 euro, nuk ka ndryshuar që nga viti 2011 dhe është më e ulëta në Evropë, sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave, Eurostat.

Projektligji që do t’i hapte rrugë rritjes së saj është miratuar në lexim të parë në qershor të vitit të kaluar dhe, nga ajo kohë, nuk ka pasur ndonjë lëvizje tjetër.

Murati: Kompanitë t’i rritin pagat për punëtorët

Në shtator të vitit të kaluar, kur Qeveria e Kosovës ka nisur të ndajë ndihma prej 50 eurosh për punëtorët në sektorin publik, ajo ka miratuar edhe një pako mbështetëse për bizneset që ua rritin pagat punëtorëve.

Qeveria ka thënë se do të subvenciononte 50 për qind të rritjes së pagës për punëtorët -

maksimumi 100 euro për tre muajt e parë. Por, tash për tash nuk ka të dhëna se sa punëtorë të sektorit privat mund të kenë përfituar nga kjo pako.

Ministri i Financave, Pumës dhe Transfereve i Kosovës, Hekuran Murati, tha në një konferencë për medie më 27 janar, se punëtorëve në sektorin publik u është ofruar ndihmë, sepse punëdhënës e kanë shtetin. Nisur nga kjo, sipas tij, edhe punëtorët në sektorin privat duhet të ndihmohen nga punëdhënësi. “Kam bërë thirrje që punëdhënësit t’i rritin pagat [e punëtorëve], sepse ka mundësi dhe ne do ta mbështetim këdo që rrit pagat”, tha Murati.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka thënë më herët për “Radion Evropa e Lirë” se në sektorin privat ka pasur lëvizje të pagave, sipas mundësive që kompanitë

kanë pasur. “Diku më shumë e diku më pak. Por, qeveria është dashur ta ndihmojë edhe më shumë sektorin privat që të rriten pagat deri në normën e inflacionit”, ka thënë Rafuna.

Në Kosovë punëdhënësi më i madh është sektori privat, me më shumë se 220 mijë të punësuar. Paga mesatare bruto në këtë sektor është rreth 380 euro.

Në sektorin publik janë të punësuar mbi 80 mijë persona, me pagë mesatare bruto rreth 620 euro.

Muajt e fundit sektori privat është përballur vazhdimisht edhe me mungesa punëtorësh dhe shumë prej ankesave që kanë raportuar ata në Inspektoratin e Punës kanë pasur të bëjnë me pagat e ulëta, me orar të stërzgatur të punës, me mohim të pushimit vjetor e të tjera.

ZKA-ja: Mbi 800 mijë euro vlera e dëmit nga menaxhimi i pronave shoqërore nga AKP-ja

PRISHTINË, 1 SHKURT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka gjetur se vlera e dëmit nga menaxhimi i pronave nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) e kalon shifrën mbi 800 mijë euro. Në një konferencë për medie të mbajtur të mërkurën, ZKA-ja ka paraqitur dy raporte të auditimit.

Njëri raport është “Auditimi i të hyrave nga AKP për periudhën 2012-2021”, raporti tjetër është “Auditimi i funksionimit të sistemit të grantit të performancës komunale dhe menaxhimi i projekteve të financuara nga donatorët për vitin 2021”.

Auditorja e përgjithshme Vlora Spanca para medieve ka thënë



se rezultatet tregojnë se institucionet përgjegjëse që menaxhojnë pronat shoqërore dhe projektet e financuara nga donatorët, jo në të gjitha rastet kanë treguar performancë të

mirë. “Kemi gjetur se AKP-ja ka dështuar ta ruajë dhe ta rrisë vlerën e pronave dhe asetëve të dhëna me qira. ZKA-ja ka gjetur se 41 për qind e mostrave kanë rezultuar me parregullsi dhe vlera potenciale e humbjes nga këto raste të testuara është mbi 800 mijë euro”, ka thënë Spanca. Sipas saj, në disa raste AKP-ja kishte lidhur kontratë me uzurpuesit apo shfrytëzuesit e paligjshëm. “Gjetjet kanë vënë në pah parregullsi si keqmenaxhim me sipërfaqet e pronave shoqërore; dhënie me qira e pronave duke iu shmangur parimit të konkurrencës; mungesë e hulumtimit të çmimit të tregut; përcaktim i çmimit pa ndonjë mbështetje ligjore”, ka bërë me dije Spanca.

Si 'dorëzohet' shkenca



Nga: Aurel PLASARI

Një polemizues nuk qenqësh i një mendjeje me argumente e mia për imponimin joshkencor të emrit "Ballkan" si entitet politik. E drejta e tij. Por, nëse përdor si argument pyetjen sesi ka mundësi që shkenca iu nënshtrua një emërtese joshkencore si ajo e Zeune-s, do të pohoj që po, shkenca dorëzohet. Po jap një shembull më shumë, madje edhe më të njohur, të një gjermani vëlla të Zeune-s së Ballkanit: Hieronymus Wolf si pagëzues i Perandorinë Romake të Lindjes me emrin "Bizant".

E kam vënë në thonjëza emrin "Bizant", sepse është e faktuar historikisht që një emër të tillë Perandoria përkatëse as e përdori, as kishte nevojë ta përdorte në kuptimin perandorak. Byzantion kishte qenë në krye të herës vetëm emri i qytetit të dikurshëm, siç e kanë përmendur në kohët e tyre Polibi, Straboni, Pausania, Marcelini, Menandri etj., sa pa vajtur atje perandori Kostandin dhe pa e shndërruar qytetin në "Kostandinopojë", d.m.th. në qytetin e themeluar rish prej tij. Ndonjë autor bizantin – kështu i quajmë sot autorët në fjalë – edhe në shek. XIV ka vijuar ta quajë qytetin si së lashti. "Mbasi qëndrova disa ditë në Bizant", shkruante për shembull Joani Kantakuzen për qëndrimin e tij në Kostandinopojë. Një shembull edhe harta me titull "Byzantium nunc Constantinopolis" e Georg

Braun-it e botuar mes viteve 1572 dhe 1618.

Në konceptimin e vet korrekt ai që u quajt më vonë "Bizant" nuk ishte veçse Perandoria Romake e Lindjes ose Perandoria e Romejve: Βασιλεία τῶν Ῥωμαίων. Dhe, nuk mund të ishte ndryshe: duke e zhvendosur kryeqytetin e perandorisë në brigjet e Bosforit perandori Kostandin kishte themeluar aty "Romën e Re". Si pjesëtarë në atë Perandori as vetë grekët nuk e mbanin veten si helenë të njëhershëm, por si "romej" (Ῥωμαῖοι) dhe ky nuk ishte veçse emri i vjetër helen për banorët e Romës. Prandaj, konotacioni i emërtesës "romej" ishte më shumë politik dhe kishtar se etnik. Së këndejmi do ta përshtaste më vonë edhe Perandoria Osmane emërtimin e popullsisë në fjalë si Rum-lar, duke e përmblodhur mbarë bashkësinë e krishterë ortodokse, pavarësisht etnive, në një Rum-milet.

Ndërsa në Perandorinë Romake të Lindjes romejtë vijonin ta konsideronin veten shtetas të Perandorisë së Romës, do të ishin më vonë perëndimorët që, duke mos i pranuar ata për romej, do t'i vështronin duke i mbledhur në një thes si "grekë" në kuptimin e bashkësisë së tyre në kishën e Lindjes.

Si një orvatje për të shmangur ngatërresat e termave filologu gjerman Hieronymus Wolf (1516-1580) përdori i pari epitetet "Bizant" për Perandorinë Romake të Lindjes dhe "bizantinë" për shtetasit e saj. Vetë vitet e lindjes dhe të vdekjes së tij mjaftojnë për t'u kujtuar që në

shekullin e tij shkrimi i historisë nuk ishte mëvetësuar ende si shkencë humanistike, sikurse konceptohet tanimë e pakta që nga babai i historiografisë shkencore Leopold von Ranke (1795-1886).

Mirëpo, edhe duke mos qenë i motivuar shkencërisht, atributi "bizantine" për Perandorinë ngjiti dhe ai tanimë quhet i pranuar për nga përdorimi i rëndomtë. Ndoshta edhe ngaqë "Bizant" zëvendësoi një emërtesë ose një shpjegim të gjatë. Megjithëkëtë, sot në tekstet profesionale studimore Perandoria në fjalë vijon të emërtohet "Eastern Roman Empire", "Empire romain d'Orient", "Imperio romano de Oriente", "Восточная Римская империя" etj. J. B. Burry, për shembull, njëri ndër themeluesit e medievistikës moderne, e refuzoi prerë etiketën "Byzantinist" në veprat e tij.

Po shtoj dhe që, pikërisht për shkak të kësaj trashëgimie romake, vijoi në Kostandinopojë deri në fundin e shek. VI edhe gjuha latine si gjuhë e oborrit, e administratës, e ushtrisë. Dhe, sidomos e drejtësisë, posa që në atë Perandori e drejta që vijonte të funksiononte ishte po e drejta romake dhe me trashëgiminë e saj perandorët në Kostandinopojë mburrëshin. Përgjatë periudhës së hershme të Perandorisë Romake të Lindjes, gjuha greke përdorej për interpretime kur tekstet paraqiteshin në gjuhën latine, si edhe prej kishës. Kërshtërore janë, për shembull, të dhënat që ka nxjerrë z. Lemerle për "universitetin" e Kostandinopojës në vitin 425:

kishte tre retorë dhe dhjetë gramatikanë latinë, pesë sofistë dhe dhjetë gramatikanë grekë. Mauriku (582-602) numërohet si i pari perandor që pati për gjuhë amtare greqishten. Për Perandorinë Romake të Lindjes edhe greqishtja nuk kishte përbërë veçse një mjet – një nga mjetet e shumta të shtëna në dorë prej saj falë pushimit – dhe vetëm perandori Herakli në shek. VII e zëvendësoi latinishten si gjuhë zyrtare duke imponuar në Perandori të ashtuquajturën "greqishte bizantine". Atëherë ajo do të ishte gjuhë jo më vetëm e kishës, por edhe e shkollës, e tregtisë etj., duke u dalluar edhe për kontributin në ruajtjen dhe transmetimin e trashëgimisë së lashtë greke. Gjuhët e tjera, "vulgaret", që mund të përdreshin në Perandori si të tilla prej popujve të ndryshëm, do të gjallëroheshin më së pari si rebelim prej lëvizjeve të heretikëve, ndër to nuk përjashtohen as sprovat e ndonjë përdorimi të hershëm të gjuhës së arbërorëve. Dh. S. Shuteriqi, fjala vjen, në një punim të hershëm ka pasë formuluar edhe hipotezën që Arbëria mesjetare të ketë përbërë epiqendrën e lëvizjes "së re" heretike të Evropës. Të dhëna me interes për herezitë në Ilirik dhe Arbëri edhe te: Faveyrial, "Histoire de l'Albanie" (R. Elsie 2001).

Vetë perandorët e Kostandinopojës nuk u mbajtën ndonjëherë si perandorë të ndonjë territori "bizantin", por si perandorë të së vetmes perandori të botës. Kryeqyteti i ri i Perandorisë, që tani quhej

Kostandinopojë, konsiderohej si Roma e Re. Pohimet që perandorët e Bizantit paskëshin njohur "perandorët e shenjtë gjermanë" të Perëndimit nuk kanë bazë faktike. Asnjë perandor i Bizantit nuk rezultoi të ketë pranuar që ekzistonte ndonjë tjetër perandor në Romë, në Aahen, në Paris a gjetiu. Roma politike për ta ishte në "Qytetin e Kostandinit". Edhe kur shfaqej ndonjë i tillë në territorin e dikurshëm të ish-Perandorisë Romake, me logjikën e perandorëve të "Bizantit" ai quhej ose uzurpator ose sundimtar i deleguar nga Perandori i Kostandinopojës. Trajtohej si mbret, jo më shumë. Me ta as krushqi nuk bëhej, e pakta deri në gjysmën e dytë të shek. X, kur Othoni II i Saksonisë, i shpallur "Perandori i Shenjtë i Perëndimit", ia delte të merrte për grua një princshë bizantine, një Theofano bijë e perandorit Joan Cimiskës. Ajo bëhej kështu perandoreshë e "Perandorisë së Shenjtë Romake". Ndarja më dysh e botës së krishterë, me një pjesë të Perëndimit dhe një pjesë të Lindjes, kjo po: ishte e pranueshme për Kostandinopojën dhe Kostandinopojën mund ta toleronte një situatë të tillë si të përkohshme, d.m.th. duke i rezervuar vetes të drejtën e kthimit edhe në Perëndim.

Vetë imponimi i "Bizantit" dhe i "bizantinëve", siç shihet, nuk është veçse një ndër shembuj e shumë të histori sesi shkenca mund të "dorëzohet" edhe para emërtesash aksidentale që funksionojnë tanimë si konvencione.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kategorizimi i sportistëve, Distria e Nora me pikë maksimale

PRISHTINË, 1 SHKURT - Komiteti Olimpik i Kosovës ka bërë kategorizimin e sportistëve për vitin 2023. Me këtë rast, komisioni ka vendosur që xhudistet Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova t'i vlerësojë me maksimum pikësh, nga 100. Pas medalisteve të arta olimpikë gjendet olimpistja tjetër

kosovare, Majlinda Kelmendi, me 60 pikë, njëjtë si xhudisti Akil Gjakova. Ndërkohë është bërë kategorizimi i sportistëve edhe në boks, karate dhe sporte të tjera. Në total, 35 sportistë janë kategorizuar për vitin 2023 bazuar në rezultatet e tyre. Të gjithë do të përfitojnë mbështetje financiare nga Ministria Sportit.

LISTA E SPORTISTËVE:

Xhudo: Distria Krasniqi (100), Nora Gjakova (100), Majlinda Kelmendi (60), Akil Gjakova (60), Laura Fazliu (50), Lorian Kuka (40), Erza Muninoviç (30), Flaka Loxha (30), Dardan Cena (20), Shpat Zekaj (20), Muhaedin Veseli (10), Debora Gjakova (10).

Boks: Donjeta Sadiku (60), Patriot Behrami (25), Shpejtim Bajoku (20).

Mundje: Egzon Shala (35).

Taekwondo: Lorent Arifi (10), Denis Bllaca (6.25).

Karate: Herolind Nishevci (40), Fortesa Orana (25), Elahmi Shabani (20), Albinot Selmani (10), Diellza Sejdijaj (10), Vlera Qerimi (9.37), Elmedina Istogu (8.75), Islam Selmani (7.5), Endrit Beka (7.5), Endrit Shaqiri (6.25), Rinesa Selmani (5.63), Behije Mustafa (5.63).

Aletikë: Muhamet Ramadani (30), Gresa Bakraqi (10).

Bodybuilding: Kushtrim Bajraktari (35), Granit Kuleta (20).

Sporti Universitar: Betim Maliqi (12.5).



Kosova në fazën kryesore kualifikuese për 'Euro 2024'



PRISHTINË, 1 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll (femrat) do të fillojë për herë të dytë kualifikimet për Evropian prej fazës së dytë. Ndërkohë për herë të tretë gjithsej, hendbollistet "dardane" do të paraqiten në fazën kryesore kualifikuese. Prej 11 tetorit të këtij viti e deri më 7 prill të vitit të ardhshëm do të zhvillohet faza e dytë kualifikuese për "Euro 2024". Në mesin e

kombëtareve pjesëmarrëse do të jetë edhe Kosova. Madje me shumë mundësi Kosova për short do të jetë në vazon e tretë, për herë të parë në histori. Kjo do të jetë dëshmi për ngritjen e Përfaqësueses së Kosovës. Do të formohen tetë grupe me nga katër kombëtare. Dy të parët në secilin grup dhe katër kombëtares më të mira të pozitës së tretë do të kualifikohen në "Euro 2024".

Ndeshjet kualifikuese do të zhvillohen përgjatë tri grumbullimeve me nga dy ndeshje. Shorti do të tërhiqet në prill. Në prill fillimisht hendbollistet tona i presin dy ndeshjet vendimtare me Poloninë, për një vend në Botërorin e këtij viti. Ndeshja e parë është në Poloni më 6 prill, ndërsa e kthimit më 12 prill në Istog.

FFK-ja: Janë plotësuar kushtet për licencim

PRISHTINË, 1 SHKURT - Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën është konstatuar se me ndryshimin e statutit të federatës janë plotësuar kriteret për licencimin e FFK-së nga Komisioni Vlerësues për Licencimin e Federatave nga

MKRS-ja. Në këtë mbledhje është miratuar orari i ri i garave. "KE shqyrtoi edhe licencimin e FFK-së dhe konstatoi se me miratimin e Statutit të ri janë plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet për licencimin e FFK-së. Po ashtu, KE shqyrtoi dhe miratoi orarin e



garave të stinorit pranveror të Kampionatit 2022/2023, i cili fillon me ndeshjet e kupës më 4 shkurt dhe do të përfundojë më 28 maj 2023", thuhet në njoftimin e FFK-së. Federata e Futbollit të Kosovës nuk është licencuar ende nga MKRS-ja dhe një prej pikave të

moslicencimit ishte ndryshimi i statutit. Ende nuk dihet nëse Komisioni Vlerësues për Licencimin e Federatave ka shqyrtuar statutin e ri, por deri tani FFK-ja është pa licencë. Për shkak të moslicencimit të federatës, klubet nuk mund të përfitojnë nga Ligji për Sponsorizim.

Bashkimi humbet ndeshjen me rezultat zyrtar në BIBL

PRIZREN, 1 SHKURT - Skuadra Bashkimi nuk ka udhëtuar të martën për ta zhvilluar ndeshjen ndaj skuadrës malazeze Milenijumit për

shkak të gjendjes së rënduar në ekip si pasojë e gripit që ka kapluar disa lojtarë. Kjo ka bërë që Bordi i Ligës BIBL ta regjistroi ndeshjen me rezultat

zyrtar në favor të skuadrës malazeze. Kështu KB Bashkimi edhe zyrtarisht e ka humbur ndeshjen me rezultat 20:0. Krahas humbjes me rezultat

zyrtar, Bashkimi i është dhënë pika e humbësit për shkak të përpjekjeve maksimale për udhëtim, por që në fund nuk u realizua.



Fernandezi bëhet transferimi më i shtrenjtë në Premierë Ligë

LONDËR, 1 SHKURT - Tashmë ka ardhur edhe zyrtarizimi, Enzo Fernandez bëhet transferimi më i shtrenjtë në historinë e Premierë Ligës. Chelsea ka përfunduar me sukses

negociatat me Benficën për mesfushorin argjentinas. Enzo Fernandez është veshur blu për shifrën e çmëndur prej 121 milionë eurosh të cilat nuk do të shkojnë të gjitha në arkat e

klubit portugez. Ish-klubi i 22-vjeçarit, River Plate, do të arkëtojë plot 41 milionë euro nga shuma e 121 milionë eurove nga transferimi i tij te Chelsea. Enzo Fernandez tashmë është

bërë lojtari më i shtrenjtë në historinë e Premierligës, duke kaluar Jack Grealish. Ky i fundit u transferua te Manchester City në verën e 2021-shit për shifrën 117 milionë euro.



Klitschko, mesazh drithërues kreut të olimpizmit botëror: Mos e bëj atë gabim, historia do të të gjykojë

KIEV, 1 SHKURT - Wladimir Klitschko, ish-boksieri kampion bote në peshën e rëndë, ka postuar një mesazh të fortë në rrjetet sociale, drejtuar presidentit të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach. Një mesazh që vjen pas deklaratës së kreut të olimpizmit botëror, që synon t'i rikthejë në Lojërat Olimpikë, duke nisur nga Paris 2024, sportistët rusë e bjellorusë, të dënuar e përjashtuar pas pushimit të Ukrainës. "I dashur Thomas Bach, ti je presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. Ti je njeriu që përfaqëson vlerat universale të tolerancës dhe paqes. Së fundi ke propozuar për t'i rikthyer sportistët rusë e bjellorusë në Lojërat Olimpikë, duke nisur nga Olimpiada e Parisit në vitin 2024", është shprehur Klitschko. "Po të them diçka. Rusët janë kampionë olimpikë për krimet ndaj civilëve. Ata e kanë fituar medaljen e artë



në trafikimin e fëmijëve dhe përdhunimin e grave. Nuk mund ta vendosësh imazhin e Olimpiadës te këta kriminelë, pasi do të ishte bashkëpunëtor i kësaj lufte të ashpër në Ukrainë. Mos e bëj këtë gjë, pasi do ta tradhtosh shpirtin olimpik", ka shkruar Klitschko.

Në fund, Klitschko i bën apel

Bach: "Një vend që shkel principet thelbësore të të drejtave ndërkombëtare nuk mund të legjitimohet dhe mbështetet nga organizata ndërkombëtare e sportit. Mos e bëj këtë gabim, këtë gabim kolosal. Bota po të vëzhgon dhe historia do të të gjykojë. Paç fat me vendimin që do ta marrësh!".

Lakesat triumfojnë, Milwaukee synon kreun në Lindje

NJU-JORK, 1 SHKURT - Skuadra e Milwaukee korri fitoren e pestë radhazi në kampionat, duke mundur me rezultat 124-115 Charlotten. Sukses që e afron Bucksin me kreun e renditjes në Lindje. Tjetër ndeshje e mirë për grekun Giannis Antetokounmpo, autor i 34 pikëve e 18 reboundeve. Rikthehet te fitorja ekipi i lakersave, që mundi me rezultat 129-123 New Yorkun pas një loje spektakolare. LeBron Jamesi, protagonist me një "triple double", autor i 28 pikëve, 10 reboundeve e 11 asistimeve, mbështetur edhe nga Anthony



Davis me 27 pikë. Jashtë fushës fiton Miami, që mundi me rezultat 100-97 Clevelandin, takim ku u dallua Butleri me 23 pikë. Fiton edhe skuadra e clippersave, që mundi me rezultat 108-103 Chicagon. Kawhi Leonard me 33 pikë ishte lider në fushë për ekipin nga Los Anxhelosi. Në krye të renditjes

në Konferencën e Perëndimit qëndron skuadra e Denverit, që e mposhti me shifrat 122-113 New Orleansin. Të gjithë titullarët e Denverit realizuan mbi 10 pikë, ku diferencën e bëri Jamal Murray me 32 pikë, mbështetur nga Nikola Jokiqi me një "triple-double" (26 pikë, 18 rebounde e 15 asistime).

REZULTATET

Cleveland - Miami	97-100
New York - Lakers	123-129
Chicago - Clippers	103-108
Milwaukee - Charlotte	124-115
Denver - New Orleans	122-113

SHKURT

Vushtrria përforcohet me Tahirin dhe Chibuezen

Skuadra e Vushtrrisë është përforcuar me dy futbollistë. Bëhet fjalë për Hysen Tahirin dhe Henry Chibuezen. "FC Vushtrria njofton se ka arritur marrëveshje me sulmuesit Hysen Tahiri dhe Henry Chibueze gjatë kësaj periudhe të mbetur të kampionatit. Tahiri ishte pjesë e KF Drenica, ndërsa Chibueze vjen nga KF Dukagjini e këtë sezon do t'i mbrojnë ngjyrat e FC Vushtrria", thuhet në njoftimin në klubin vushtrrias. FC Vushtrria është pjesë e Ligës së Parë të Kosovës në futboll.

FC Ferizaj paraqet përforcimet e janarit


Ferizaj, ndonëse gjendet në vendin e fundit në tabelë, nuk e ka ndër mend të dorëzohet dhe në pranverë do të luftojë për ta siguruar mbijetesën. Skuadra ferizajase tashmë ka bërë të gjitha përgatitjet dhe duket e gatshme për stinorin pranveror derisa edhe ka bërë disa përforcime interesante. Shtatë prurje të reja besohet se do t'i ndihmojnë asaj të arrijë tek objektivat që i ka. Çlirim Avdulli, Jasmin Mecinovic, Besar Iseni, Marko Jovanovski, Filip Gligorov, Albin Krasniqi dhe Drilon Islami janë emrat e ri që në pjesën e dytë të kampionatit do ta veshin fanellën e Ferizajt. Ferizaj është i fundit në tabelë me vetëm 13 pikë të tubuara në 18 ndeshje të luajtura në stinorin vjeshtor dhe e pret një punë shumë e madhe.

Dështon kalimi i Ziyechit te PSG-ja

Ka dështuar kalimi i Hakim Ziyech te PSG-ja. Komisioni ligjor i LFP-së, liga franceze e futbollit, në faktin se ka refuzuar ankesën e tij nga klubi francez, i cili mbrëmjen e djeshme, ditën e fundit të merkatos së janarit, nuk mund ta zyrtarizonte afrimin e sulmuesit maroken pasi Chelsea vonoi dokumentin e duhur. PSG-ja u ankua për këtë gjë, por Ziyech do të mbetet te Chelsea.

Jorginho: Arteta ndikoi në ardhjen time këtu

Mesfushori Jorginho ishte dhurata e fundit e drejtuesve të Arsenalit për trajnerin Mikel Arteta. Mesfushori italian u transferua nga Chelsea te kryesuesit e Premierë Ligës për 15 milionë euro. 31-vjeçari ka firmosur deri në vitin 2024 me Arsenalin. "E di që Arteta është përpjekur të më marrë në ekip edhe më parë, por nuk ia doli kurrë për shkaqe të ndryshme. Ai kishte një ndikim të madh në ardhjen time këtu. Mezi po pres të filloj këtë aventurë dhe të zbris në fushë. Transferimi im ndodhi shumë shpejt, u befasova edhe vetë, por ia dola ta shfrytëzoja rastin. Fanella e Arsenalit është shumë e rëndësishme. Kam ardhur në një klub të madh dhe po e pres me padurim debutimin tim", ka deklaruar Jorginho.



Ibra rikthehet ndaj Torinos

Zlatan Ibrahimoviç pas një kohe të gjatë rikthehet pas një lëndimi në momentet më delikate për Milanin. "Corriere della Sera" raporton se Ibra do të

jetë në fushë kundër Torinos më 10 shkurt. Objektivi i stafit drejtues është t'i japë disa minuta Ibrës, të mos e sforcojë shumë, pasi dëshiron ta ketë në

dispozicion me kohë të plotë për ndeshjen kundër Tottenhamit në Ligën e Kampionëve. Gjithashtu, në këtë ndeshje rikthehen edhe

Maignan dhe Tomori. Të gjithë në klubin kuqezi shpresojnë që Ibra t'i rregullojë gjërat në dhomat e zhveshjes pasi atmosfera nuk është pozitive.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Drejtoria e Arsimit
05NR. 111-7742
Datë 01.02.2023

Në bazë të nenit 5, të Rregullores mbi ndarjen e bursave për nxënës dhe student të Komunës së Suharekës 01-Nr-016-7790 të datës 31.01.2019, Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores 01-nr-016-7543 të datës 29.01.2021, Drejtoria Komunale e Arsimit në Suharekë në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës 01 Nr.016-7114 të datës 30.01.2023 shpall këtë:

KONKURS

Për ndarjen e bursave për nxënës dhe student për vitin shkollor 2022/2023

Drejtoria e arsimit për vitin shkollor 2022/2023, shpall konkurs për 350 bursa (200 bursa për student dhe 150 bursa për nxënës të shkollave të mesme të larta). Bursat ndahen vetëm për student dhe nxënës që janë banor të përhershëm të Komunës së Suharekës dhe që i vijnë mësimit/studimet themelore në shkollat përkatësisht Universitetet publike të Kosovës.

Vlera e bursës për një vit akademik- shkollor do të jetë:

- Për student/e 50 € në muaj për 10 muaj
- Për nxënës /e 25 € në muaj për 10 muaj

Kushtet dhe kriteret:

- Të ketë të regjistruar vitin shkollor/akademik për të cilin jepet bursa.
- Të mos jetë shfrytëzues/e i ndonjë burse tjetër e cila dëshmohet me vërtetim nga fakulteti ku studion.
- Për kandidatët/et që janë regjistruar për herë të parë në fakultet të kenë dëshminë e suksesit të vitit paraprak (diploma dhe dëftesa e vitit të fundit të shkollës së mesme të lartë)
- Gjendja ekonomike sociale e familjes e cila dëshmohet me vërtetim nga Qendra për punë sociale.

Vlerësimi i kushteve dhe kriterëve:

Fëmijët e dëshmorëve të cilët janë student dhe nxënës të shkollave të mesme të larta, do të ju ndahet bursa jashtë kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore, por të gjithë studentët dhe nxënësit e kësaj kategorie janë të obliguar ta sjellin vërtetimin e regjistrimit të semestrit për vitin akademik të studimeve për të cilin ndahet bursa.

• Kriteret dhe prioritetet për fitimin e së drejtës në bursë janë si më poshtë:

1. Nota mesatare 9.5 deri në 10.00, në fakultet, vlerësohen me 30 pikë,
2. Nota mesatare 8.5 deri në 9.49 në fakultet, vlerësohen me 20 pikë,
4. Nota mesatare 7.5 deri në 8.49 në fakultet, vlerësohen me 15 pikë,
5. Nota mesatare 7 deri në 7.49 në fakultet, vlerësohen me 5 pikë.
6. Nota mesatare 6 deri në 6.99 në fakultet, vlerësohen me 3 pikë
7. Suksesi i shkëlqyeshëm 4.5 deri në 5 në shkollat e mesme të larta vlerësohet me 25 pikë,
8. Suksesi shumë mirë 3.5 deri në 4.49 në shkollat e mesme vlerësohet me 15 pikë,
9. Suksesi i mirë 3 deri në 3.49 në shkollën e mesme vlerësohet me 8 pikë,
10. Suksesi i mjaftueshëm 2 deri 2.99 në shkollën e mesme vlerësohet me 3 pikë,
11. Për familjet që kanë 2 (dy) studentë nga e njëjta familje 10 pikë,
12. Për familjet që kanë tre student (vëllezër-motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë të tjera.
13. Për kandidatët e SHML që kanë dy nxënës nga e njëjta familje vlerësohen me 10 pikë.
14. Për familjet që kanë tre (3) nxënës në shkollat e mesme të larta (SHML), (vëllezër -motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë.
15. Pikët e studentëve janë të vlefshme vetëm për kategorinë e studentëve dhe pikët e nxënësve llogariten vetëm për kategorinë e nxënësve të të njëjtës familje.
16. Gjendja ekonomike- financiare (rastet sociale) vlerësohen me 30 pikë.
17. Studentët/ nxënësit të cilët nuk kanë asnjërin prind në jetë, fitojnë bursën pa kriteret e përcaktuara me rregulloren, me kusht që të kenë të regjistruar vitin e ri akademik (dëshmi vërtetimi për regjistrimin e semestrit),
18. Fëmijët pa njërin prind vlerësohen me 10 pikë, e cila vërtetohet me certifikatë të vdekjes ose me deklaratë të bashkësisë familjare.
19. Fëmijët me dy prindërit me nevoja të veçanta me dëshmi mjekësore fitojnë bursën pa kriteret e përcaktuara me rregulloren, me kusht që të kenë të regjistruar vitin e ri akademik (dëshmi vërtetimi për regjistrimin e semestrit),
20. Fëmijët me nevoja të veçanta, ndërsa të dy prindërit janë në gjendje normale vlerësohen me 10 pikë.
21. Fëmijët me njërin prind me nevoja të veçanta dhe vetë fëmija me nevoja të veçanta vlerësohen me 15 pikë.
21. Fëmijët e ish të burgosurve politikë dhe ish të dënuarve politikë, vlerësohen me 8 pikë,
19. Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së, vlerësohen me 10 pikë,
20. Studentët/et, nxënësit/et të cilët nuk kanë asnjërin prind të punësuar, e cila vërtetohet me dëshmi/vërtetim nga Enti i punësimit dhe nuk krijojnë të ardhura nga ndonjë veprimtari tjetër dobi prurëse, vlerësohen me 15 pikë, por këto pikë nuk llogariten edhe për studentët/et, nxënësit/et, të cilët marrin asistencë sociale.
22. Fëmijët e viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë vlerësohen me 12 pikë,
23. Fëmijët e veteranëve të luftës të UÇK-së vlerësohen me 8 pikë.
24. Nga e njëjta familje mund të përfiton bursë vetëm një student/e dhe nxënës/e, pa marrë parasysh kategorinë e tyre.
25. Nxënësit/et, që kanë poentim të barabartë pas shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë nxënësit/et që kanë distancë më të largët nga institucionet shkollore.

Përfitues të bursës nuk mund të jenë këto kategori:

1. Studentët/et dhe nxënësit/et, që kanë dy prind të punësuar në institucionet publike (shtetërore).
2. Studentët/et dhe nxënësit/et, që prindërit e tyre kanë biznes të regjistruar dhe aktiv, e cila dëshmohet me vërtetim nga Qendra e regjistrimit të biznesit.
3. Përfitues i kësaj burse nuk mund të jetë studenti/nxënësi, nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e arsimit.
4. Nëse vërtetohet se studenti i cili është përfitues i bursës nga komuna, merr bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore, ai/ajo obligohet ta kthejë bursën.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ✓ Kërkesa sipas formës së përpiluar nga Drejtoria e arsimit;
- ✓ Vërtetimin se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2022/23 (origjinale);
- ✓ Certifikata e notave (origjinale);
- ✓ Vërtetimin se studenti/ja nuk është përfitues/e i/e bursës universitare;
- ✓ Ekstraktin e lindjes;
- ✓ Kopja e letërnjoftimit;
- ✓ Vërtetim mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2022/23 ;
- ✓ Për studentët e regjistruar në vitin shkollor/akademik 2022/23, kopjet e vërtetuara të dëftesave dhe të diplomës së shkollës paraprake.

Afati i konkurrimit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data 02.02.2023 deri më datë 16.02.2023.

Dokumentet dorëzohen sipas afatit të konkursit dhe nuk pranohet plotësim i dokumentave pas mbylljes së konkursit.

Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen të kompletuara në Komunën e Suharekës, zyra nr. 1 çdo ditë pune prej orës 8:00 derimë 16:00

Drejtoria e Arsimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 01.02.2023 bënë shpallje publike:

NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-23-01

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e një pjese të objektit Metalurgjinë e Zinkut.
Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë
Numri i ofertave të pranuar: 1

ME KONTRATË SHPËRBLEHET

NNSh Nazi me çmimin për m² - 2.65 € pa TVSH

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 07.02.2023 ora 10:00

NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-23-02

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e dy restoranteve në Miniera e Stan Tergut dhe Flotacioni Tunel i parë
Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë
Numri i ofertave të pranuar: 3

ME KONTRATË SHPËRBLEHET

481- N.T.H. Caffeteria “Charli” me çmimin prej 1,201.71 euro

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 07.02.2023 ora 10:00

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: hajdini_b@hotmail.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepçacorporation.com		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kutrilin&Kraja” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811292359 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kutrilin&Kraja” L.L.C. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811292359 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Kutrilin&Kraja” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811292359 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr.Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e vendeve të punës në KMDK SH.A, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe bazuar në Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A me Nr.06/2023 me numër të protokollit 02-07/6, KMDK SH.A shpall këtë:

KONKURS PUBLIK (PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS)

Titulli: Ngasës i Makinerisë së Rëndë /Manipulator – 1 (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-2-2023

I raporton: Përgjegjësit të Deponisë Sanitare

Niveli i pagës: VIII

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: Deponia Sanitare Landovicë, Prizren

Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Të respektojë Udhëzimet e dhëna nga Përgjegjësi i deponisë dhe Inxhinieri i Makinerisë lidhur me përdorimin e makinerisë;
- Ti respektojë rregullat dhe udhëzimet e përcaktuara për makinerinë e rëndë;
- Ti respektojë rregullat e caktuara të komunikacionit;
- Të jetë fleksibil në punë, të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në kolektiv;
- Para çdo vozitje të bëjë kontrollimin e gjendjes së makinerisë;
- Të njoftojë për çdo defekt të makinerisë tek Përgjegjësi i deponisë;
- Pas çdo përdorimi të bëjë kontrollin, pastrimin dhe ta kthejë makinerinë në vendin e caktuar;
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së PD;
- Për punën e vet jep përgjegjësi, Përgjegjësit të deponisë.

Kualifikimet:

- Diploma e shkollës fillore.
- Minimum 1 vjet përvojë pune.

Aftësitë kryesore

- Të posedojë Patentë Shofer të kategorisë përkatëse.

Procedura e konkurimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web-faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrë e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga "Bekim Fehmiu" Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Tel: 038/ 600 – 552.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- CV,
- Diploma,
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet,
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së, duke filluar nga data: 02.02.2023 deri me datën 16.02.2023 ora 08:00-16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyren e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Tel: 038/ 600 – 552.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr.Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

Na osnove Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Zakon br. 03/L-212 o radu, posebno član 8 Uredbe br. 23/2020 o postupku zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK S.A., Administrativno uputstvo (MPMS) br. 07/2017 o uređenju postupaka za zasnivanje radnog odnosa u javnom sektoru i na osnovu Odluke od glavnog izvršnog direktora KMDK SH.A sa br. 06/2023 sa protokolom broj 02-07 KMDK dd saopštava:

JAVNI KONKURS

(ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA)

Naziv: Vozač/manipulator teških mašina – 1 (jedna) pozicija

Referentni broj: ZP/KJ-2-2023

Izveštava: Upravitelj sanitarne deponije

Visina plate: VIII

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno vremena (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mesto rada: Sanitarne deponije-Landovica, Prizren

Dužnosti i odgovornosti:

- Da poštuje uputstva koja su dali upravnik deponije i mašinski inženjer vezano za upotrebu mašina;
- da poštuje pravila i uputstva definisana za teške mašine;
- Morate poštovati određena saobraćajna pravila;
- Da bude fleksibilni na poslu, spremni za rad pod pritiskom i u timu;
- Provjeriti stanje mašine prije svake vožnje;
- Obavestiti upravnika deponije o bilo kakvom kvaru mašine;
- Nakon svake upotrebe provjerite, očistite i vratite mašinu na predviđeno mesto;
- Obavlja i druge poslove po zahtjevu DP;
- Odgovornost za svoj rad daje upravniku deponije.

Kvalifikacije:

- Diploma osnovne škole.
- Minimalno 1 godina radnog iskustva.

Ključne vještine

- Posjedovati vozačku dozvolu odgovarajuće kategorije.

Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični formular u kancelariji za ljudske resurse KMDK SH.A ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji kancelariji za ljudske resurse na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Priština, Kosovo (blizu škole Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Telefon: 038/ 600 – 552.

Kandidati koji se takmiče moraju ispravno unijeti adresu, kontakt telefon i email adresu. Samo odabrani kandidati će biti pozvani na dalje procedure zapošljavanja.

Potrebna dokumentacija:

- životopis
- stepen,
- Sertifikati o kvalifikacijama i obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi na osnovu kvalifikacija i vještina.

Napomena: Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one nepotpune sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u novinama/platformama i elektronskim stranicama KMDK, počev od: 02.02.2023. do 16.02.2023, 08:00-16:00 sati.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 – 552.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitore Zabërgja shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Zain Skenderi shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

- Arlind Gashi shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren .

- Isuf Avdyli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curri " Krushe e Madhe.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.